



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 241, datë 15.11.2018

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKGAZ” SHPK., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 83 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; si dhe nenit 4, pika 1, gërma “ç”; neneve 5; 8 dhe nenit 10, pikat 1 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”; miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 97, Datë 04.07.2017; nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike lidhur me fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “BALKGAZ”shpk, në aktivitetin e tregëtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)

Konstatoi se:

- Me shkresën me Nr. 704 Prot, datë 05.11.2018, shoqëria “BALKGAZ” sh.p.k, ka aplikuar në ERE për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregëtimit të gazit natyror.
- **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1, gërmat “a“ ; “b””; “c””; “d” , pikat “i:; “ii””; “iii”, dhe “iv””. Plotësuar.
- **Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1, gërma “e”, pikat “ii””; v; vi. Plotësuar;
- **Dokumente Specifike për Llojin e Licencës**, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:
 - Neni 9, pika 2, gërma “i’ dhe “ iii” Plotësuar;
gërma “ii” Plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

- **Gërmën “e”, “Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale”,** pika “i” (Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej Aplikantit); pikën “vii” (Në se Aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tija ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një Garanci të Performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi);
- **Pikën 2, “Dokumente Specifike për Llojin e Licencës”,** gërma “ii”, (Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit), do të njoftohet subjekti që në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”*, ti paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BALKGAZ” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë të aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI